EMRAT/ Tentuan të vrisnin një person rreth dy javë më parë, arrestohet 27-vjeçari në Korçë dhe një nga bashkëpunëtorët

07 Korrik, 2024 11:32

Madhësia e tekstit:

Një 27-vjeçar i cili ishte shpallur në kërkim, ka përfunduar në prangat e policisë.

I riu ishte shpallur në kërkim në lidhje me një ngjarje të ndodhur me 19 qershor ku në bashkëpunim me katër shtetas të tjerë tentuan të vrisnin një person.

Njoftimi:

Korçë-Vijon me intensitet shatimi i masave të përcaktuara në planin operacional mbarëkombëtar "Sundimi i ligjit".

Kapet dhe vihet në pranga 27-vjeçari i shpallur në kërkim, në lidhje me ngjarjen e ndodhur më datë 19.06.2024, ku në bashkëpunim me 4 shtetas të tjerë tentuan të vrisnin shtetasin M. I.

Arrestohet në flagrancë edhe një shtetas tjetër, i cili përkrahu 27-vjeçarin dhe posedonte në banesë armë zjarri me municion.

Procedohen penalisht edhe 2 të tjerë, të cilët fshehën provat materiale të kryerjes së krimit.

Sekuestrohen 1 armë zjarri automatike dhe municione luftarake.

Komisariati i Policisë Korçë, në zbatim të masave të planit operacional "Sundimi i ligjit", për kapjen e personave në kërkim dhe në vijim të punës betimore për dokumentimin e plotë të ngjarjes së ndodhur më datë 19.06.2024, në lagjen nr. 17, Korçë, bazuar në informacionet e siguruara nga inteligjenca policore, mbi vendndodhjen e njërit prej shtetasve të shpallur lidhur me këtë ngjarje, kanë intensifikuar kontrollet për kapjen dhe vënien e tij përpara përgjegjësisë ligjore.

Si rezultat nga këto struktura në bashkëpunim me Forcën e Posaçme "Shqiponja" të DVP Korçë, u bë kapja dhe ndalimi i shtetasit në kërkim:

– Andrea Diamandi 27 vjeç, banues në Korçë, pasi më datë 19.06.2024, në aksin rrugor "Korçë-Voskop", në bashkëpunim me shtetasit S. S., 25 vjeç, S. S., 33 vjeç, Dh. D., 33 vjeç, dhe M. B., 39 vjeç, banues në Korçë, me automjetin "Rang Rover" kanë përplasur automjetin me drejtues shtetasin M. I., 18 vjeç, të cilin dyshohet se kanë tentuar t'a vrasin duke e goditur me mjete të forta në dukje armë zjarri, e cila nuk ka realizuar qëllje.

Në vijim të veprimeve të kryera po në lidhje me këtë ngjarje, u arrestua në flagrancë shtetasi:

Idlir Spaho, 51 vjeç, banues në Korçë, pasi ky shtetas dyshohet se ka përkrahur 27-vjeçarin A. D., me të cilin ka lidhje shoqërore. Nga kontrolli i ushtruar në banesën e shtetasit I. D., në lagjen nr. 4, Korçë, u gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri automatike dhe 1 krehër me 30 fishekë.

Gjithashtu po nga këto struktura filloi procedimi penal për shtetasit V. D., 62 vjeç dhe R. S., 44 vjeç, banues në Korçë, pasi dyshohet se këta shtetas kanë ndihmuar autorët e ngjarjes, të fshehin provat materiale, që kanë shërbyer për kryerjen e krimit.

Po punohet për kapjen dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të shtetasve të tjerë të përfshirë në këtë ngjarje.

Materialet procedurale i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

SONDAZH

A mendoni se Sylvinho duhet të vazhdojë punën si trajner i kombëtares shqiptare?

- Po
- Jo
- Nuk e di

Vota

Rezultatet

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" nisëm në klikoni: Join Group dhe kërkoni do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

TË NGJASHME

Ze 14 gjithë e prisnin Nolandin dori kërc', Kosmasi i lumtur pas kualifikimit: Anglia ka hajduti fë mirë aj kemi edhe na, dëshirojë finalen
07 Korrik, 2024

Ndodh edhe kjo! I lagës me ujë, ja si i pëlcitë nga kokaku turlitës
07 Korrik, 2024

Taboola Feed

Order the fully electric EX30 and design it your way.
Volvo Cars · Sponsored
Learn More

This Weight Loss Hack Takes Louth by Storm
Lose weight, keep it off. Request weight loss injections that help you lose 22% more weight. G...
Ozlo · Sponsored
Click Here


Cheap Bargain Holidays Are Still Available (Take A Look)
Travelo Vacation · Sponsored
Learn More


Higher Ed: Master Work-Based Learning with Our Top Tips
Discover the top tips for building your Work-Based Learning strategy in our free 1hr webinar. Learn from the best in the field and hear real success stories.
Pearson · Sponsored
Learn More


Louth: £19.99 Will-Writing Service
Don't be a no-will nightmare! Limited-Time Offer for Over 50's!
Legacy Wills & Estate Planning · Sponsored


Single over 50 in Louth? Try Ourtime today!
Ourtime · Sponsored
Sign Up

Top Tips Webinar for Higher Ed: Experiential Learning
Discover the top tips for building your Work-Based Learning strategy in our free 1hr webinar. Learn from the best in the field and hear real success stories.
Pearson · Sponsored
Learn More

TË FUNDIT NGA KRONIKË

Merr flakë në ecje autonjetë në akses Dukat-Dërmës, shpëtojnë rrëshqitësit shofer!
07 Korrik, 2024

Mbi 11700 njësha dhe 15 të arrestuar/ Policia Rrugore e Tiranës bën bilancin e 1 javë
07 Korrik, 2024

Sërish aksidente në Pogradec, autonjetët përplasen një person me biçikletë dhe një kërndisur, dëmtohen
07 Korrik, 2024

Drogë dhe armë/ 15 të ndaluar dhe 18 arrestuar në Durrës, zbardhen emrat
07 Korrik, 2024

Tjetërsuan 7500 m2 truall, Prokuroria çon pre gjykimi 3 bashkëpunëtorë
07 Korrik, 2024

Operacioni "Summer", 15 të arrestuar dhe ndalohet/ Sekuestrohen armë e drogë
07 Korrik, 2024

KATEGORIA VIDEO

Drogë dhe armë/ 15 të ndaluar dhe 18 arrestuar në Durrës, zbardhen emrat
07 Korrik, 2024

Pir 1 milion vota/ Franca e ndarë mes të djathtës ekstreme dhe të majtës radikale
07 Korrik, 2024

Burdisi dhe Noka takime në Kombinat: Protesta e 11 korrikut, betejë pa kthim dari në formëmin e qeverisë takisha
06 Korrik, 2024

Zhduajca e 54-tonë metalene në Kombinatin e Pultjukit, prokuroria thërret Blerd Çuçin. Auditi zbului dinein, pse gjetjet ka dijmi edhe ministri Peleshi
06 Korrik, 2024

Vrau partnerin e labërashkëlurtes, policia jep detaje për krimin në Fier: Si ndodhi ngjarja
06 Korrik, 2024

VIDEO/ Fluka lëvizjesh në dhë pushimi, por firma kryen punime, kërkohet fryga e Arlerit
Enver Daçi | 06 Korrik, 2024

BalkanWeb TV

Higher Ed: Master Work-Based Learning with O...
Pearson · Sponsored
Read Next Story ›

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2024 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.